



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-05
Prokurori kundër Salih Mustafës

Vendosi: **Trupi Gjykes I**
Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse
Gjykatës Roland Dekers
Gjykatës Zhilber Biti
Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 9 shkurt 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim i Tretë mbi Zhvillimin e Gjykimit

T'i njoftohet:

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit:
Julius von Bone

Mbrojtëses së viktimave:
Ani Pues

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues) nxjerr këtë vendim të tretë mbi zhvillimin e gjykimit.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 21 janar 2022, Trupi Gjykues nxori “Vendimin e dytë mbi zhvillimin e gjykimit” (“Vendimi”), në të cilin vendosi, ndërmjet të tjerave, të mbante një konferencë përgatitore për Mbrojtjen së bashku me një konferencë për ecurinë e çështjes për viktimat pjesëmarrëse, të enjten, më 17 shkurt 2022, duke caktuar të premtën, 18 shkurt 2022, si ditë rezervë (“konferenca përgatitore”), dhe t’u kërkonte palëve, mbrojtëses së viktimave dhe Zyrës Administrative që në përputhje me Vendimin, të bënin parashtrime me shkrim brenda afateve të caktuara.¹
2. Më 4 shkurt 2022, Mbrojtja e Salih Mustafës (z. Mustafa ose i akuzuari) dorëzoi “Njoftimin e Mbrojtjes sipas rregullës 130 (1) për Trupin Gjykues në lidhje me synimin e Mbrojtjes për të paraqitur mocion për rrëzimin e ndonjë ose të gjitha akuzave në aktakuzë” (“Njoftimi sipas Rregullës 130(1)”).²
3. Gjithashtu, më 4 shkurt 2022, Trupi Gjykues nxori “Vendimin mbi zbatimin e nenit 22(9) të Ligjit, ku përcaktohen hapat e mëtejshëm proceduralë në këtë çështje dhe ku kërkohet informacion” (“Vendimi mbi Zbatimin e Nenit 22(9)”),³

¹ KSC-BC-2020-05, F00296, Trupi Gjykues I, *Vendim i Dytë mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 21 janar 2022, publik, para. 21(f)-(i). Vendimi i parë mbi zhvillimin e gjykimit u lëshua më 26 gusht 2021, *shih* F00170, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 26 gusht 2021, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00309, Mbrojtja, *Njoftim i Mbrojtjes sipas Rregullës 130 (1) për Trupin Gjykues në lidhje me Synimin e Mbrojtjes për të Paraqitur Mocion për Rrëzimin e Ndonjë ose të Gjitha Akuzave në Aktakuzë*, 4 shkurt 2022, publik.

³ KSC-BC-2020-05, F00310, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi Zbatimin e Nenit 22(9) të Ligjit, ku Përcaktohen Hapat e Mëtejshëm Proceduralë në Këtë Çështje dhe ku Kërkohet Informacion*, 4 shkurt 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë (F00310/RED).

në të cilin Trupi Gjykes ndër të tjera urdhëroi dhe/ose i kërkoi mbrojtëses së viktimave të dorëzonte parashtrime me shkrim brenda afateve të caktuara.⁴

4. Në të njëjtën ditë, Mbrojtja gjithashtu dorëzoi “Njoftimin e Mbrojtjes sipas rregullës 119 (1) për paraqitjen e provave të Mbrojtjes” (“Njoftimi sipas Rregullës 119(1)”).⁵

5. Më 8 shkurt 2022, Trupi Gjykes nxori “Urdhër për parashtrime mbi zhvillimin e gjykimit pas njoftimit të Mbrojtjes sipas rregullës 130 (1) për synimin e saj për të paraqitur mocion për rrëzimin e ndonjë ose të gjitha akuzave në aktakuzë” (“Urdhri”).⁶ Në Urdhër, Trupi Gjykes u kërkoi palëve dhe mbrojtëses së viktimave të dorëzonin parashtrimet e tyre nëse datat për mbajtjen e konferencës përgatitore dhe për afatet e dorëzimit të parashtrimeve përkatëse me shkrim duhej të mbeteshin të pandryshuara.⁷

6. Më 7 shkurt 2022, Trupi Gjykes mori parashtrimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS),⁸ Mbrojtjes,⁹ dhe mbrojtëses së viktimave.¹⁰

⁴ Vendimi mbi Zbatimin e Nenit 22(9), para. 50(c)-(d).

⁵ KSC-BC-2020-05, F00312, Mbrojtja, *Njoftim i Mbrojtjes sipas Rregullës 119 (1) për Paraqitjen e Provave të Mbrojtjes*, 4 shkurt 2022, publik.

⁶ KSC-BC-2020-05, F00314, Trupi Gjykes I, *Urdhër për parashtrime mbi zhvillimin e gjykimit pas Njoftimit të Mbrojtjes sipas Rregullës 130(1) për Synimin e saj për të Paraqitur Mocion për Rrëzimin e Ndonjë ose të Gjitha Akuzave në Aktakuzë*, 8 shkurt 2022, publik.

⁷ Urdhri para 6-7.

⁸ KSC-BC-2020-05, F00316, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë mbi Zhvillimin e Gjykimit pas Njoftimit të Mbrojtjes sipas Rregullës 130(1)* (“Parashtrimet e ZPS-së”), 9 shkurt 2022, publike.

⁹ KSC-BC-2020-05, F00317, Mbrojtja, *Parashtrime të Mbrojtjes në vijim të Urdhrit të Trupit Gjykes për Parashtrime mbi Zhvillimin e Gjykimit pas Njoftimit të Mbrojtjes sipas Rregullës 130(1)* (“Parashtrimet e Mbrojtjes”), 9 shkurt 2022, publike.

¹⁰ KSC-BC-2020-05, F00315, Mbrojtësja e Viktimave, *Parashtrime të mbrojtëses së viktimave mbi Konferencën Përgatitore për Mbrojtjen dhe Konferencën për Ecurinë e Çështjes për Viktimat Pjesëmarrëse të caktuar për 17 dhe 18 shkurt 2022 dhe Parashtrime me Shkrim të lidhura me To* (“Parashtrimet e Mbrojtëses së Viktimave”), 9 shkurt 2022, publike.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Trupi Gjykses në dukje nënet 21(4)(d) dhe 40(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 9(5)(a), 116(5), 119 dhe 130 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja").

III. PARASHTRIMET

8. ZPS-ja parashtron se gjykimi duhet të vazhdojë në përputhje me afatet e përcaktuara në Vendim.¹¹ ZPS-ja argumenton se kjo nuk do të cenojë të akuzuarin dhe do të garantojë më së miri shpejtësinë e gjykimit, duke marrë parasysh se Mbrojtja nuk ka bërë kërkesë për pezullimin e këtyre afateve, dhe se kjo nuk cenon vendimin e Trupit Gjykses mbi mocionin e ardhshëm sipas rregullës 130.¹²

9. Mbrojtësja e viktimave parashtron se është e gatshme të marrë pjesë në konferencën përgatitore dhe të dorëzojë parashtrimet përkatëse me shkrim, dhe se konferenca përgatitore duhet të mbahet nëse palët dhe mbrojtësja e viktimave janë në gjendje të bëjnë parashtrime të mirëfillta lidhur me rendin e ditës të saj.¹³ Mbrojtësja e viktimave gjithashtu argumenton se konferenca përgatitore duhet të shtyhet nëse Mbrojtja nuk do të paraqesë parashtrimet e kërkuara nga Trupi Gjykses në Vendim.¹⁴

10. Mbrojtja parashtron se datat për mbajtjen e konferencës përgatitore dhe për afatet përkatëse për dorëzimin e parashtrimeve me shkrim nuk duhet të mbeten të njëjtat, mbështetur në arsyetimin se një vendim i Trupit Gjykses për rrëzimin e disa prej akuzave do të ndikonte në llojin dhe gjatësinë e listave të dëshmitarëve

¹¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 2.

¹² Parashtrimet e ZPS-së, para. 2-3.

¹³ Parashtrimet e Mbrojtësës së Viktimave, para. 2-3.

¹⁴ Parashtrimet e Mbrojtësës së Viktimave, para. 4.

dhe të provave materiale që do të dorëzohen nga Mbrojtja.¹⁵ Përveç kësaj, Mbrojtja pretendon se mbajtja e konferencës përgatitore para marrjes së vendimit mbi mocionin sipas rregullës 130 do të cenonte integritetin e procesit dhe të drejtën e të akuzuarit për një vendim të paanshëm mbi mocionin, pasi do të binte ndesh me përparësinë që ka një mocion sipas rregullës 130 mbi mbajtjen e konferencës përgatitore dhe afatet përkatëse për parashtrimet me shkrim.¹⁶ Më tej Mbrojtja parashtron se çdo vonesë e shkaktuar nga marrja në radhë të parë e një vendimi mbi mocionin sipas rregullës 130 nuk do të kishte ndikim mbi shpejtësinë e procesit.¹⁷ Duke pasur parasysh sa më lart, Mbrojtja parashtron se konferenca përgatitore, së bashku me afatet përkatëse, duhet të pezullohen deri sa Trupi Gjykes të marrë vendimin mbi mocionin sipas rregullës 130.¹⁸

IV. ANALIZË

11. Duke marrë parasysh parashtrimet e palëve dhe të mbrojtëses së viktimave dhe për të garantuar që gjykimi do të vazhdojë të jetë i drejtë dhe i shpejtë, Trupi Gjykes e gjykon të përshtatshme të anulojë afatet e përcaktuara në paragrafët 21(f)-(i) të Vendimit, duke përfshirë datën dhe orën e Konferencës Përgatitore të caktuar për 17-18 shkurt 2022, si dhe afatet në paragrafët 50(c) dhe (d) të Vendimit mbi Nenin 22(9).

12. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes cakton një kalendar të ri për hapat e mëtejshëm proceduralë, si në vijim. Trupi Gjykes e konsideron të përshtatshme të shkurtojë - në përputhje me rregullën 9(5)(a) të Rregullores - afatin e Mbrojtjes për parashtrimin e mocionit sipas rregullës 130, i cili duhet të dorëzohet deri të

¹⁵ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 9, 11-13.

¹⁶ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 16, 24.

¹⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 25.

¹⁸ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 21-23.

martën, më 15 shkurt 2022, në orën 16:00. Trupi Gjykses e konsideron të përshtatshme të shkurtojë edhe afatet e ZPS-së dhe mbrojtëses së viktimave për parashtrimin e përgjigjeve me shkrim , nëse do të ketë, të cilat duhet të dorëzohen deri të hënë më 21 shkurt 2022, në orën 16:00. Më pas, Trupi Gjykses synon të marrë një vendim mbi mocionin sipas rregullës 130 ndërmjet 23 dhe 25 shkurtit 2022.

13. Nëse mocioni sipas rregullës 130 do të rrëzohet tërësisht ose pjesërisht, Mbrojtja duhet të dorëzojë materialin e përmendur në paragrafin 21(f) të Vendimit, deri të martën, më 1 mars 2022. Gjithashtu, mbrojtësja e viktimave duhet të dorëzojë materialin e përmendur në paragrafin 21(g) të Vendimit dhe paragrafin 50(c) të Vendimit mbi Zbatimin e Nenit 22(9), deri të martën, më 1 mars 2022. Mbrojtja, nëse dëshiron, mund t'u përgjigjet parashtrimeve të mbrojtëses së viktimave të përmendura në paragrafët 50(c) të Vendimit mbi Zbatimin e Nenit 22(9), deri të hënë, 7 mars 2022, në mesditë.

14. Në varësi të vendimit mbi mocionin sipas rregullës 130, Trupi Gjykses më tej vendos të shtyjë konferencën përgatitore, në praninë e ZPS-së, Mbrojtjes, mbrojtëses së viktimave dhe një përfaqësuesi të Zyrës Administrative, deri të martën, 8 mars 2022, në orën 09:30, me të mërkurën, 9 mars 2022, si ditë rezervë, duke filluar në orën 09:30. Rendi i ditës i konferencës përgatitore do të jetë ai që specifikohet në pjesët III.C dhe III.D të Vendimit.

15. ZPS-ja, Mbrojtja, mbrojtësja e viktimave dhe Zyra Administrative duhet t'i dorëzojnë parashtrimet e tyre me shkrim mbi pikat e specifikuar në paragrafin 20 të Vendimit deri të hënë, 7 mars 2022, në mesditë.

V. VENDIM

16. Për arsyet e mësipërme, Trupi Gjykses:

- a. **ANULON** afatet e caktuara në paragrafin 21(f)-(i) të Vendimit, përfshirë mbajtjen e konferencës përgatitore më 17-18 shkurt 2022, si dhe afatet e përcaktuara në paragrafët 50(c) dhe (d) të Vendimit mbi Zbatimin e Nenit 22(9);
- b. **VENDOS** të shkurtojë afatet për parashtrimin e mocionit sipas rregullës 130 nga Mbrojtja dhe të përgjigjeve të ZPS-së dhe mbrojtëses së viktimave, nëse do të ketë, në përputhje me paragrafin 12 të këtij vendimi; dhe
- c. **VENDOS**, në varësi të vendimit të Trupit Gjykses mbi mocionin e ardhshëm sipas rregullës 130, të caktojë një kalendar të ri për hapat e mëtejshëm proceduralë, siç specifikohet në paragrafët 13-15 të këtij vendimi, si dhe për konferencën përgatitore, e cila do të mbahet **të martën, më 8 mars 2022**, në orën 09:30, dhe cakton **të premtën, 9 mars 2022** si ditë rezervë, duke filluar në orën 09:30.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia

Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E mërkurë, 9 shkurt 2022

Hagë, Holandë.